

# RAPORTI TOPOGRAFIK

## OBJEKTI

### FURNIZIMI ME UJË

### PËR FSHATRA PICAR & KOLONJË TË BASHKISË GJIROKASTËR

(PROJEKT – ZBATIM)

VITI 2024

PROJEKTUES	INVESTITOR	KLIENT
<b>C.E.C GROUP</b> <i>LICENCE N.6635/11</i>	<b>MINISTRIA E INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISE</b>	<b>SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES- KANALIZIME SH.A GJIROKASTER</b>
		

**PERMBAJTJA**

HYRJE	3
RRJETI GJEODEZIK PLANIMETRIK (BENCHMARKS)	4
STACIONET POLIGONALE	5
NDERTIMI I STACIONEVE	6
MATJA E STACIONEVE ME GPS	6
KRIJIMI I HARTES DIXHITALE	7

## HYRJE

Projekti synon sigurimin e furnizimit me ujë higjenikisht të paster dhe 24 ore shërbim të pandërprerë. Futjen e tarifave të pranueshme shoqërore që mbulojnë të paktën kostot O&M. Qëllimi i përgjithshëm është të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës së popullatës rurale.

Ky projekt përfshin fshatrat Picar dhe Kolonje të Bashkisë Gjirokaster. Gjirokastra ndodhet në qendër të Shqipërisë Jug – Lindore. Zona e studimit në të cilën përfshihet dalja e burimit, bën pjesë në Bashkinë Gjirokastër dhe kap pjesën veriore të saj, që nga veriu i lumit të Kardhiqit, gjithë pjesën malore, luginën e fshatit Kaparrjelë e në perëndim.

Fshati Picar dhe Kolonje shtrihen në perëndim të rrugës nacionale hyrëse Tirane-Gjirokaster. Ndodhet 15km larg në vijë ajrore me qytetin. Rruga hyrëse për në Picar dhe Kolonje është asfaltuar, në gjendje relativisht të mirë. Rruga nga Fshati Kolonje deri në Burimin e Rehoves pjesë e skemes është rrugë rurale me zhavor.

Automjetet e rënda mund të hyjnë në terren pothuajse gjatë gjithë vitit, duke përjashtuar rastet kur mund të ketë debore. Çka do të kerkonte mirmbajtjen dhe pastrimin e këtyre rrugëve. Rezervuarët ekzistues dhe të rinj ndodhen afër rrugëve në fshatra.






Punimet topografike u kryen nga Grupi Topografik i C.E.C Group. Perpara fillimit te punimeve topografike, Grupi Topografik u njoh me zonen dhe terrenin ku do te zbatohet projekti. U siguruan te gjitha materialet paraprake hartografike dhe topografike te nevojshme per te gjitha Proceset Topografike.

### RRJETI GJEODEZIK PLANIMETRIK (BENCHMARKS)

I quajtur ndryshe edhe si “Triangulacioni i Shqipërisë”, është zhvilluar në tre rinde dhe përbëhet prej rreth 1800 pikash gjeodezike, me një dëndësi mesatare 1 pikëpër 15,6, të fiksuara në terren në mënyrë solide dhe sipas kërkesave përkatëse. Triangulacioni i rendit të parë (fig.1.3) përbën një rrjet të plotë trekëndëshash me formë pothuajse të rregullt gjeometrik edhe me brinjë mesatare rreth 16km. Ky rrjet përbëhet prej 159 pikash dhe mbështetet në shtatë brinjë fillestare, të cilat ndodhen përkatësisht në Shkodër, Krumë, Durës, Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Sarandë. Në pikat fundore të brinjëve fillestare dhe të brinjës së hyrjes (Kamëz-Tapizë) të rrjetit të rendit të parë janë përcaktuar azimutet e Laplasit. Si pike fillestare e rrjetit u përcaktua pika e re astronomike (N8814) në Kamëz në afërsi të Universitetit Bujqësor, meqënëse pika e mëparëshme astronomike e Tiranës, e përcaktuar nga Instituti Gjeografik Ushtarak i Firences, rezultonte eprishur. Triangulacioni shtetëror i ndërtuar nga ITU plotëson kërkesën e dëndësisë për rievimin topografik në shkallën 1:5000. Gabimi

standart në pikat e këtij rrjeti nuk e kalon vlerën 12 cm. Kuotat e pikave të triangulacionit me lartësi deri në 500 m, si dhetëpikavenë terrene me pjerrësi jo tëmadhe, u përftuannëpërmjet-nivelimitgjeometrikshitetëror. Kuotat e pikave të tjera të triangulacionit u përcaktuan me anën e nivelimit gjeodezik.



### STACIONET POLIGONALE

Proçesi topografik i ndermarre nga Konsulenti konsiston ne krijimin e nje harte dixhitale te gjithë gjatesise se segmentit rrugor, qe do te perdoret per qellime projektimi. Keto stacione (te vendosura pergjate te gjithë gjurmes) do te perdoren gjithashtu si reference gjate implementimit te punimeve te ndertimit.

Vezhgimi u realizua duke perdorur sistemin nderkombetar UTM, me elipsoid wgs84. Permes

ketij sistemi, koordinatat gjeodezike mund te identifikohen lehtesisht per cdo pike interesi ne sipërfaqen e tokes bazuar ne te dhenat GPS.

Stacionet jane vendosur ne afersiterretit rrugortematerializuarne sinjalistike celikudhebetoni.

Punet topografike konsistojne ne hapat e meposhtem:

- Ndertimi i stacioneve
- Matja me GPS ne te gjithë stacionet
- Rilevimi i detajuar i gjithë bllokut ne studim
- Krijimi i hartes dixhitale

### NDERTIMI I STACIONEVE

Stacionet jane ndertuar ne interval rreth 500-1000m njeri nga tjetri. Ato u ndertuan duke perdorur shufra hekuri me gjatesi 70cm te vendosura ne spote me permasa 40x40cm, thellesi 60cm dhe jane vendosur mbimure betoni, rrethues etj. Ndertimi i tyre u be ne vende qe sigurojne jetegjatesi, me qellim qe te sherbejne per ndertimin e rruges se re.

Te gjitha stacionet jane shenjuar me ngjyre te kuqe, per te qene qartesisht te shikueshem. Per cdo pike eshte vizatuar vendndodhja precize, duke e identifikuar ate ne lidhje me objektet fikse dhe lidhur me dosjet dixhitale, te cilat perfaqesojne monografine e pikave polygonale.



### MATJA E STACIONEVE ME GPS

Realizimi i matjeve me GPS eshte kryer per te gjithëstacionet, duke perdorur “GPS DualFrequency receivers”. Per te arritur nje precision te larte dhe matje sa me tesakta, eshte perdorur metoda e matjeve te mini-triangolacioneve. Ne matjen e stacioneve me GPS eshte perdorur menyra e matjeve “Faststatic”. Matja e çdo pike me GPS eshte realizuar per 20-30min, duke marre parasysh numrin e sateliteve ne kohen e matjeve.

Instrumentat e perdorur kane qene TRIMBLE R6 MODEL 3 GPS. Mbas matjeve eshte kryer

perpunimi i te dhenave me programin Trimble Business Center. Rezultati i ketyre matjeve eshte i bashkangjitur raportit perkates topografik. Ky instrument perfaqeson disa nga teknologjite me te mira ne treg.



### KRIJIMI I HARTES DIXHITALE

Te gjitha elementet dhe karakteristikat topografike jane regjistruar me kode te vecanta nememorien e brendshme te instrumentave te perdorur nga Konsulenti.

Tek keto elemente perfshihen karexhata e rruges, puseta - kuneta, bordurat, linja elektrike, ndertesa, hyrjet e shtepive, peme, kryqezime rruges, rilevimet e shesheve te rezervuareve dhe stacioneve te pompave, etj.

Mbas punes ne terren eshte bere perpunimi i te dhenave te matura ne terren me anen e programit Sierrasoft Prost. Pikat e rilevuara jane hedhur ne AutoCAD ku eshte bere dhe lidhja e elementeve (bazuar tek kodet) e te gjithe zones duke krijuar nje vizatim unik.

Vizatimi eshte bere ne 3 dimensione, ne menyre qe mund te krijoj me modelin e terrenit ne menyre dixhitale. Jane paraqitur te gjitha detajet e relievit si rruge, mure, ndertesa, rrethime, linja elektrike, etj., ne layera te vecanta. Te gjitha stacionet jane paraqitur me shenje konvencionale ne vizatim.

Modeli dixhital i terrenit eshte paraqitur ne file dwg si me poshte

- ✓ Tre - dimensional (x,y,z), pika gjeodezike ne nje layer te vetem.
- ✓ Tre - dimensional (x,y,z) linjat e nderprerjes se terrenit, si dhe elementet e tjere topografike te terrenit ne layera te ndryshem.